



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1720 prot.

Gramsh, më 23/04/2024

**NJOFTIM**

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak;  
Të nderuar këshilltarë, Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për funksionimin e Këshillit Bashkiak Gramsh”, njoftoj se mbledhja e muajit PRILL do të zhvillohet ditën e HËNË datë 29/04/2024 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit, me rend dite si më poshtë:

- 1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin MARS 2024 (fondi 6%) (Sek.Ndih.Sociale).
- 2- Për miratimin e projektit teknik “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare Rilindja”. (Dr.Finances&Buxheti).
- 3- Për miratimin e shpenzimeve faktike të buxhetit për vitin 2023. (Dr.Finances&Buxheti).
- 4- Për miratimin e pjesmarrjes së Bashkisë Gramsh në Ankandin Publik që do të zhvillohet nga Enti Kombëtar i Banesave me objekt shitjen e 12(dymbëdhjetë) garazhdeve me sipërfaqe totale 351.03 m2 në banesën me 8 kate dhe një kat parkim nën tokë e ndërtuar me fondet e EKB-së në qytetin e Gramshit. (Dr.Finances&Buxheti).
- 5- Për miratimin e një sipërfaqe trualli prej 540 m2 (pesëqind e dyzetë) metra katrorë, pjesë e pasurisë 8/132, zonë kadastrale 1842 e cila është në pronësi të Bashkisë Gramsh, si truall për ndërtimin e objektit, që do të ndërtohet nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me kosto të ulët, për qëllime strehimi. (Dr.Planifikimit&Zhvill.Territorit).
- 6- Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101 datë 30.11.2022 “Për emërtimin e Shkollës së Mesme nga “Xhezar Meçi” në “Skënder Buzdra” në Njësinë Administrative Poroçan dhe emërtimin e Qendrës Shëndetësore në Njësinë Administrative Kukur në “Xhezar Meçi”. (Kryetari i Këshillit).
- 7- Kërkesa të qytetarëve, Të tjera.

*Duke ju falenderuar!*

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT  
Luis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1719 prot.

Gramsh, më 23/04/2024

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17,56, 57 dhe "Rregulloren për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Gramsh", Kryesia e Këshillit të Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e dates . .2024:

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Gramsh, e cila do të mbahet në datën 29.04.2024.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës të çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Gramsh, Deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre të secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Xhulia Gjini

Konç. M.H. Gjini  
Konç. F. Zani  
Marsic  
Doja  
Aliti

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Enis Zani

